

Dy artikuj qëllimisht tendenciozë ndaj "Devolli Group"

Me anë të kësaj shkrese, duam të reagojmë për dy shkrime të njëanshme dhe si të tilla edhe tendencioze, me qëllim dëmtimin pa të drejtë të kompanisë sonë.

Bëhet fjalë për shkrimin "Favorizimi i Devollëve, anëtari i bordit të ZrRE-së që ndërroi qëndrim brenda 45 ditëve", me autore Dorentina Kastrati, botuar më 25.12.2019, si dhe shkrimin "Vendimi i ZRRE-së favorizon Devollët", me autorë Dorentina Kastrati dhe Valon Fana, botuar më 24.12.2019, në portalin informativ Kallxo.com.

Të dyja këto shkrime, duke filluar nga titulli dhe vazhduar me përmbajtjen, theksin e qëllmishëm negativ e vëjnë të kompania "Devolli Group", duke e veçuar atë nga shumë kompani të tjera të cilat kanë marrë autorizime të ligjshme preliminare nga ZRRE-ja për ndërtimin e kapaciteteve energjetike dhe që janë në listën e pritjes.

Në brendësi të këtyre artikujve shihet se autorizime të këtilla nga ZRRE-ja kanë marrë edhe kompani të tjera, kushtet dhe rregullat e vendosura vlejnë edhe për kompanitë e tjera, të vendit ose të jashtme, të cilat kanë aplikuar për leje. Përse Kallxo.com ka vendosur ta veçojë "Devolli Group", ta vendosë dy herë në tituj dhe ta pasqyrojë në kontekst negativ, ne nuk e kemi të qartë.

Gjithashtu, për të dy këta artikuj, ne asnjëherë nuk kemi pranuar ndonjë telefonatë, ose email, me pyetje nga ana e gazetarëve të cilët i kanë shkruar këta artikuj, duke na e shkelur kështu të drejtën e garantuar me Kushtetutë të shprehjes së mendimit tonë.

Me këtë rast, ne duam të potencojmë se "Devolli Group", si kompani vendore, hyn më mesin e aplikuesve për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese të rrymës me kapacitet të vogël prej 3 MW, kurse ka kompani të huaja të cilat kanë marrë autorizime për kapacitete prej 135MW (mbi 100 herë më të mëdha se kapacitetet tona), por për çudi nuk përmenden fare në këta artikuj.

Duke patur këto fakte parasys, ne kërkojmë nga Kallxo.com që ose t'i tërheqë, ose t'i redaktojë në mënyrë korrekte këto shkrime, si dhe ta botojë këtë shkresë tonën në Kallxo.com.

Nëse këto nuk ndodhin, ne do ta kërkojmë realizimin e të drejtës sonë të trajtimit të drejtë dhe të barabartë në adresa të tjera ligjore.

Singerisht,

Devolli Group